

LIGJ
Nr.7630, datë 28.10.1992

PËR STANDARDIZIMIN DHE CILËSINË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
STANDARDIZIMI

Neni 1

Standardizimi përmbledh veprimtarinë për studimin, hartimin dhe miratimin e standardeve, parastandardeve, kushteve të projektimit e zbatimit, kampionëve, modeleve, vizatimeve të punës e recepturave, si dhe drejtimin, kontrollin dhe sigurimin e cilësisë.

Ai shtrihet në gjithë veprimtarinë e personave juridikë e fizikë, vendas e të huaj, që prodhojnë, ndërtojnë e kryejnë shërbime në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç mallrave që përjashtohen me dispozita të veçanta.

Neni 2

Standardet janë dokumente në të cilat pasqyrohen kërkesa të caktuara, që ndihmojnë për organizimin dhe drejtimin shkencor të prodhimit, të ndërtimit e të shërbimit, për forcimin e disiplinës teknike e teknologjike, për përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e efektivitetit.

Neni 3

Sistemi i standardizimit përbëhet nga:

a) Standardi shqiptar (STASH), i cili përcakton kërkesat cilësore të njësuara në bazë të teknologjive të zbatuara, për lëndët e para e materialet, lëndët djegëse e produktet e gatshme, ndërtimet, shërbimet, kushtet e ambalazhimit e të etiketimit, të ruajtjes e të transportimit të prodhimeve të ndryshme dhe metodat e njësuara për vlerësimin e cilësisë së prodhimeve, të ndërtimeve e të shërbimeve.

b) Parastandardi (PS) i cili, njëloj si standardi, përcakton kërkesat cilësore për prodhimet, ndërtimet e shërbimet e reja. Me përvetësimin e teknologjisë, rishikohet për t'u ngritur në standard.

c) Kushtet e projektimit (KP) dhe të zbatimit (KZ) që vendosin disiplinën teknike e teknologjike në projektim e në zbatim.

ç) Kampioni, modeli, vizatimi i punës dhe receptura, që përcaktojnë treguesit e prodhimeve të reja për anën funksionale, përbërjen, treguesit shqisorë, përmasat e tyre etj.

Neni 4

Standardet ndahen në të detyrueshëm dhe jo të detyrueshëm. Emërtesa e standardve të detyrueshme miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Drejtorisë së Standardizimit dhe cilësisë.

Në standardet, parastandardet, kampionët, mmodelet, vizatimet e punës, recepturat e prodhimeve janë të detyrueshëm për ata tregues që çenojnë të drejtën e konsumatorit, shëndetin dhe sigurinë e jetës. Për prodhimet që nuk ka dokumente standardizimi, niveli i këtyre treguesve caktohet ose miratohet nga Drejtoria e Standardizimit dhe Cilësisë, në bashkëpunim me inspektoratet përkatëse.

Neni 5

Në standardet e makinerive e të pajisjeve , të pjesëve të ndërrimit dhe të riparim-shërbimeve të kushtueshme dhe të pajisjeve elektroshtëpiake vendoset afati i garancisë.

Në standardet, parastandardet, kampionët, recepturat e produkteve ushqimore, farmaceutike, imunobiologjike, higjieniko- shëndetësore e veterinarë, si dhe ato të prodhimeve kimike, vendoset afati i përdorimit.

Prodhuesi dhe shitësi përgjigjet për defektet që shfaqen brenda afatit të garancisë ose afatit të përborimit, kur mallrat, ndërtimet e shërbimet, ruhen e trajtohen sipas kushteve të përcaktuara në standardet, parastandardet, kushtet e zbatimit, kampionët, modelet vizatimet e punës dhe recepturat.

Neni 6

Prodhimet dhe mallrat për veprimet e shpërndarjes e për treg marketohen edhe etiketohen. Etiketa në përgjithësi përmban:

- emërtimin e plotë dhe karakteristikat kryesore të produktit ose mallit dhe markën;
- masën bruto e neto dhe përmasat e produktit ose mallit të ambalazhuar;
- datën e prodhimit dhe afatin maksimal të përdorimit;
- numrin e standardit shqiptar (STASH) që është i detyruar të vendoset në etiketat e mallrave me standarde të detyrueshme, kurse për mallrat e tjera me standarde jo të detyrueshme vendosja ose jo e numrit të standardit varet nga prodhuesi. Në rast se ky numër vendoset, prodhuesi është i detyruar që malli i tij t'i përgjigjet standarit përkatës;
- emërtimin e ndërmarrjes, të koduar, ose të plotë, dhe vendndodhjen e saj.

Neni 7

Projektet e standardeve, parastandarëve, kushteve të projektimit e të zbatimit, kampionëve, modeleve, vizatimeve të punës dhe recepturave, hartohen nga prodhuesi, institucionet shkencore dhe personat juridikë e fizikë. Ato rishikohen sipas nivelit teknologjik të arritur e kërkesave të tregut dhe i dërgohen për miratim organit të emërtesës.

Neni 8

Parastandardet, kampionët, modelet, vizatimet e punës, recepturat, miratohen nga prodhuesi në bashkëpunim me përdoruesin, ministritë dhe degët e standardeve dhe të kontrollit të cilësisë në rrethe, sipas emërtesës së caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Miratimi i parastandarëve dhe i recepturave të prodhimeve farmaceutike bëhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit, sipas kërkesave farmakopeale ndërkombëtare.

Miratimi i kushteve të projektimit (KP) dhe i kushteve të zbatimit (KZ) bëhet nga ministria përkatëse.

KREU II CILËSIA

Neni 10

Drejtimi, kontrolli dhe sigurimi i cilësisë kryhen në fazën studimore, projektuese e operative, që nga lënda e parë, gjatë procesit të prodhimit, në produktin e gatshëm dhe në kryerjen e ndërtimit e të shërbimit.

Kontrolli është procesi i vlerësimit të përputhjes së një prodhimi, ndërtimi e shërbimi me kërkesat cilësore të specifikuar nëpërmjet vëzhgimeve, matjeve e provave, karakteristikave përkatëse,

sipas dokumenteve të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji ose specifikimeve të një marrëveshjeje.

Neni 11

Në veprimtarinë e personave juridikë a fizikë funksionon sistemi i cilësisë, që përfshin punonjësit, procedurat, proceset dhe mjetet për realizimin e cilësisë.

Të gjithë personat juridikë a fizikë merren dhe përgjigjen për standardet e cilësisë në çdo fazë të prodhimit, ndërtimit e shërbimit.

Në rrethe funksionojnë degët e standardizimit dhe të kontrollit të cilësisë.

Në ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore funksionojnë organet e standardizimit dhe të kontrollit të cilësisë.

Neni 12

Ministrinë dhe organet e tjera qendrore, organet e pushtetit lokal dhe personat juridikë a fizikë drejtojnë, kontrollojnë dhe marrin masa për zbatimin e standardeve, parastandardeve, kushteve të projektimit e të zbatimit, kampionëve, modeleve, vizatimeve të punës e recepturave, për të siguruar cilësinë e prodhimeve, ndërtimeve e shërbimeve.

Neni 13

Ndalohet prodhimi, ndërtimi dhe shërbimi, kur nuk u përgjigjen standardeve të detyrueshme, deklarimeve në etiketë, kur është i falsifikuar, pa certifikatë cilësie, pa dokumentet e sigurisë e të garancisë dhe kur nxirren rezultate të gabuara e të falsifikuara të analizave laboratorike.

Mallrat me afat përdorimi të tejkaluar bllokohen, rivlerësohen, dhe, mbi bazën e rezultateve të analizave, u shtyhet afati, u ndryshohet destinacioni ose asgjësohen.

Përcaktimi i treguesve cilësorë të vendosur në dokumentet që shoqërojnë mallin, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, bëhen vetëm me metodika të standardizuara dhe të miratuara.

Neni 14

Kanë të drejtë të ndalojnë prodhimin, ndërtimin e shërbimin, kur nuk u përgjigjen kërkesave të nenit 13 të këtij ligji, Drejtoria e Standardizimit dhe e Cilësisë, organet e standardizimit dhe të kontrollit të cilësisë në ministrinë e institucionet e tjera qendrore, degët e standardizimit dhe të kontrollit të cilësisë në rrethe dhe punonjësit e cilësisë të personave juridikë e fizikë. Kur është e nevojshme, bashkëpunohet edhe me Policinë Financiare.

KREU III

DETYRAT DHE TË DREJTAT E DREJTORISË SË STANDARDEVE E TË CILËSISË

Neni 15

Për drejtimin dhe organizimin e punës në fushën e standardizimit, çertifikimit, akreditimit (dhënies së besimit) të laboratorëve, kontrollit dhe sigurimit të cilësisë, krijohet Drejtoria e Standardizimit dhe e Cilësisë, si organ i pavarur kolegjal e vendimor, drejtori i të cilës caktohet nga Kryeministri.

Drejtoria e Standardizimit dhe e Cilësisë është person juridik me seli në Tiranë.

Neni 16

Drejtoria e Standardizimit dhe e Cilësisë ka këto detyra e të drejta:

a) Ndjek, ndihmon dhe kontrollon zbatimin drejt të dispozitave ligjore dhe të akteve të Këshillit të Ministrave në fushën e standardizimit, drejtimit, kontrollit dhe sigurimit të cilësisë së prodhimeve, të ndërtimeve e shërbimeve, në ministrinë e institucionet e tjera qendrore, në organet e

pushtetit lokal dhe në personat juridikë a fizikë.

b) Siguron udhëheqjen metodike, drejton, organizon dhe kryen vetë ose në bashkëpunim me ministritë e institucionet e tjera qendrore dhe me organet e tjera të pushtetit lokal, studime e analiza tërësore të veçanta, për të nxitur rritjen e cilësisë nëpërmjet vendosjes së treguesve cilësorë më të lartë në standarde.

Organizon grupe pune me specialistë të fushave përkatëse për hartimin e rishikimin e standardeve dhe kërkon të dhëna nga organizatat prodhuese e përdoruese.

c) Gjatë punës për hartimin e standardeve u përmbahet këtyre parimeve:

- asnjësisë;
- lirisë së kundërshtimit;
- nivelit të arritur të shkencës e të teknikës;
- kushteve konkrete ekonomike dhe nevojave të përgjithshme të shoqërisë;
- mbrojtjes së konsumatorit.

ç) Miraton standardet shqiptare për prodhimet, ndërtimet, shërbimet, metodat e analizave dhe amendamentet e tyre. Sipas nevojave të ekonomisë, në bashkëpunim me organizmat kombëtare të standardizimit të vendeve të tjera, harmonizon standarde të prodhimeve, ndërtimeve e shërbimeve ose tregues të veçantë të tyre.

Kur e gjykon të nevojshme, përshtat standardet ndërkombëtare (ISO), rajonale e të vendeve të tjera, si standarde kombëtare.

Vendos rregullat, procedurën e çertifikimit, dhënien e markës së konformitetit (përputhjen me kërkesat e standardit), për prodhimet dhe ndërtimet e shërbimit.

d) Cakton tarifat për të gjitha llojet e shërbimeve që kryen për të tretët, si dhe interpretimi i standardeve, ekspertizat, certifikimin dhe akreditimin (dhënien e besimit) e laboratorëve.

dh) Kontrollon zbatimin e standardeve, parastandardeve, kushteve të projektimit e të zbatimit, kampionëve, modeleve dhe cilësinë në personat juridikë a fizikë.

e) Merr pjesë në ekspertizat shtetërore dhe private për problemet e cilësisë, në formulimin e aktit përkatës, dhe kërkon zbatimin e tij.

ë) Organizon dhe drejton sistemin kombëtar të akreditimit (dhënies së besimit) të laboratorëve. Autorizon laboratorët e vendit për kryerjen e analizave laboratorike, që kërkojnë për verifikimin e cilësisë.

f) Ndjek problemet e kualifikimit e të specializimit të punonjësve të organizmave të standardizimit dhe të cilësisë.

Neni 17

Për miratimin e standardeve shqiptare në Drejtorinë e Standardizimit dhe Cilësisë funksionon këshilli i standardizimit.

Numri dhe përbërja e anëtarëve të këshillit të standardizimit miratohen nga drejtori i Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë.

Neni 18

Drejtorja e Standardizimit dhe e Cilësisë përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO). Mban lidhje të drejtpërdrejta me organizatat ndërkombëtare dhe me organizmat kombëtare të standardizimit, cilësisë, akreditimit e të çertifikimit dhe vendos bashkëpunimin me to në fushën e informacionit, të shkëmbimit të literaturës, të përvojës, të kualifikimit për standardizimin, cilësinë, akreditimin dhe certifikimin.

Neni 19

Prodhimi, ndërtimi, shërbimi dhe shitja e produkteve e mallrave, në kundërshtim me nenin 13 të këtij ligji, janë shkelje dhe, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen si kundërvajtje administrative me gjobë nga 5000 deri në 10 000 lekë ndaj personave fizikë fajtorë dhe nga 50 000 deri në 100 000 lekë ndaj personave juridikë fajtorë.

Neni 20

Të drejtën e dhënies së gjobës deri në 100 000 lekë e kanë punonjësit e Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë, punonjësit e standardizimit e të kontrollit të cilësisë të ministrive e të institucioneve të tjera qendrore dhe të degëve të standardizimit e të kontrollit të cilësisë të rretheve.

Të drejtën e dhënies së gjobës deri në 5 000 lekë e kanë punonjësit e cilësisë të personave juridikë a fizikë.

Të drejtën e dhënies së gjobës ndaj punonjësve të standardizimit e të cilësisë, që kanë dijeni dhe nuk marrin masa për parandalimin e shkeljeve të parashikuara në këtë ligj e kanë specialistët:

- e Drejtorisë së Standardizimit dhe të Cilësisë ndaj punonjësve të standardizimit e të kontrollit të cilësisë dhe punonjësve të tjerë të personave juridikë a fizikë;

- e ministrive e të institucioneve të tjera qendrore ndaj punonjësve të standardizimit dhe të kontrollit të cilësisë të ndërmarrjeve që mbulojnë;

- e degëve të standardizimit e të kontrollit të cilësisë të rretheve ndaj punonjësve të standardizimit e të kontrollit të cilësisë dhe punonjësve të tjerë të personave juridikë a fizikë brenda territorit ku ushtrojnë veprimtarinë;

- e personave juridikë a fizikë ndaj punonjësve që merren e përgjigjen për zbatimin e standardeve dhe kontrollin e cilësisë.

Neni 21

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, përkatësisht, te drejtori i Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë, për dënimet e dhëna nga punonjësit e kësaj drejtorie, si dhe te titullari i ministrisë ose institucionit tjetër qendror e te kryetari i degës së standardizimit dhe të kontrollit të cilësisë të rrethit, për dënimet e dhëna nga punonjësit e tyre dhe të personave juridikë a fizikë, aktet e të cilëve janë të formës së prerë.

Gjoba është titull ekzekutiv.

Neni 22

Organet e standardizimit e të cilësisë, kur gjatë veprimtarisë së tyre vërejnë shkelje që përbëjnë vepër penale, bëjnë kallëzim në organet përkatëse.

Neni 23

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore.

Neni 24

Dekreti nr.7095, datë 17.1.1987 "Për çmimet, standardet dhe kontrollin e cilësisë", si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.346, datë 12.11.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.